

10 shtator – 10 tetor, 2013

# E-lajme

## Projekti i USAID-it “Leximi ju bën udhëheqës” Dije nga fusha e gjuhës dhe matematikës për zhvillim profesional

Projekti është i implementuar nga ana e Fondacionit për iniciativa arsimore dhe kulturore “Hap pas hapi” -Maqedoni



Xhejms Stajn, Drejtor i Misionit të USAID-it

“Dija nga fusha e gjuhës dhe matematikës nuk u përket vetëm arsimtarëve, shkollave ose institucioneve arsimore. Ajo prek aspekte të shumta prej jetës sonë të përditshme dhe të gjithë ne kemi rol të rëndësishëm në ndërtimin e kulturës për shkrim-lexim në Maqedoni. Secili prej nesh mund të kontribuojë për arsim më të mirë për fëmijët tonë, dhe për atë arsye ju inkurajoj të merrni pjesë në aktivitetet e planifikuara pranë Projektit “Leximi ju bën udhëheqës” dhe të punoni me nxënësit nga klasave të ulëta.” - Xhejms Stajn, Drejtor i Misionit të USAID-it, në fjalimin e tij gjatë hapjes solemne të projektit.

### Të nderuar lexues,

Me kënaqësi e ndajmë me ju edicionin e parë të E-lajmeve nga Projekti i USAID-it “Leximi ju bën udhëheqës”. Me E-lajmet do t’ju informojmë për aktivitetet e kaluara, por edhe do t’ju njoftojmë për të gjitha aktivitetet dhe ngjarje që vijnë. Kënaquni në përmbajtjet të cilat shpresojmë se do t’ju nxisin për t’u përfshirë në projektin, për shkak se dija nga gjuha dhe matematika është me rëndësi për të gjithë ne!

*Përshëndetje nga ekipi i projektit*

## HAPJA ZYRTARE E PROJEKTIT TONË

Më 12 shtator, në Bibliotekën shtetërore dhe universitare “Sh. Kliment i Ohrit” në Shkup, ekipi i Projektit “Leximi ju bën udhëheqës” dhe USAID Maqedonia e shënuan hapjen solemne e projektit me përfaqësuesit e institucioneve arsimore, përfaqësuesit nga shkollat dhe komunitetet lokale. Byroja për zhvillim të arsimit, Qendra shtetërore e testimit dhe partnerët e tjerë të projektit edhe një herë e vërtetuan mbështetjen e tyre ndaj projektit.

Qendra për fëmijët me materiale për lexim, matematikë dhe punë kreative u mbush me zhurmë fëmijërore nga nxënësit e klasave të ulëta prej disa shkollave fillore, të cilët së bashku me prindërit e tyre punuan në mjedis të këndshëm dhe frymëzues, dhe u zbatën me një sesion leximi të përbashkët me aktorët e famshëm, Amernis Nokshiqi dhe Sashko Koccev.



Në këtë mënyrë ne e shënuam Ditën Botërore e shkrim-leximit, e cila festohet çdo vit më 8 tetor nëpër botë.

## Janë përzgjedhur shkollat të cilat do të marrin pjesë në aktivitetet e projektit

Si përgjigje të thirrjes për kyçe të shkollave fillore, e cila ishte hapur prej 11 deri në 25 shtator, në zyrën tonë arritën aplikacione prej 190 shkollave prej 65 komunave prej të gjitha rajoneve të shtetit. Për shkak të numrit të madh aplikacionesh cilësore, Komisioni për vlerësim të aplikacioneve kishte detyrë të vështirë gjatë seleksionimit të shkollave. Interesi dhe numri i lartë aplikacionesh prej shkollave është një vërtetim plotësues se ka nevojë për projekte të këtij tipi në shkollat fillore në shtetin tonë.

### Projekti “Leximi ju bën udhëheqës” u kyç në ngjarje humanitare në Shkup

“Leximi ju bën udhëheqës” mori pjesë dhe mbështeti ngjarjen humanitare, e cila u mbajt në 5 tetor në Bibliotekën e qytetit të Shkupit “Vëllezërit Milladinov”. Numër të madh personash publike siç politikanë, këngëtarë, aktorë, shkrimtarë dhe sportistë luanin rolin e bibliotekarëve gjatë asaj dite. Mjetet e mbledhura prej anëtarësimit të anëtarëve të rinj në bibliotekës gjatë asaj dite do të shfrytëzohen për pajisje të një biblioteke-kënd për lojërë në Klinikën universitare për sëmundje fëmijërore në Shkup.



#### INICIATIVA NË KOMUNITETIN:

Ekipi i Projektit “Leximi ju bën udhëheqës” së shpejti do të vijë në komunitetin tuaj lokal me aktivitete interesante. Pa dallim a jeni arsimtar ose prind të nxënësve nga njëra prej shkollave të përzgjedhura për pjesëmarrje në projektin, ose të ndonjë shkolle që nuk është përzgjedhur për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë, jeni të mirëpritur të kyçeni në aktivitetet tona. Duhet vetëm të shprehni interes për pjesëmarrje në aktivitetet, me të cilat së bashku do të kontribuojmë për përmirësim të dijës nga fusha e gjuhës dhe matematikës dhe do të ndërtojmë kulturë për shkrim-lexim.

Do të keni më shumë detaje së shpejti!!

Për të gjitha informacione plotësuese, mund të kontaktoni me Ana Dimovska me postë elektronike: [ana@stepbystep.org.mk](mailto:ana@stepbystep.org.mk) ose cel: 072/ 307-321

Fondacioni për iniciativë arsimore dhe kulturore “Hap pas hapi” Maqedoni  
bul. Partizanski odredi nr.72a  
1000 Shkup, Maqedoni

### Këto janë shkollat e përzgjedhura për pjesëmarrje në fazën-pilot të projektit:

Shkolla fillore	Vendi	Komuna
Stiv Naumov	Shkup	Gazi Babë
Naum Naumovski - Borçe	Shkup	Gazi Babë
11 Tetori	Shkup	Qendër
Bllazhe Koneski	Shkup	Aerodrom
Petar Zdravkovski - Penko	Shkup	Butel
Goce Dellçev	f. Mogillë	Mogillë
Koço Racin	f. Ivanjevci	Mogillë
Sh. Kiril dhe Metodi	Manastir	Manastir
Elpida Karamandi	Manastir	Manastir
Kiril dhe Metodi	Koçan	Koçan
Slavço Stojmenski	Vinicë	Vinicë
Goce Dellçev	f. Konçe	Konçe
Sh. Kliment i Ohrit	Ohër	Ohër
Naim Frasheri	f. Jagol Dolenci	Krçovë
Sande Shterjoski	Krçovë	Krçovë
Simche Nastovski	f. Vratnicë	Jegunovce
Bratsvo Migjeni	Tetovë	Tetovë
Hristijan Todorovski Karposh	f. Dragomance	Nagorichani i Vjetër
Ilinden	Kriva Palankë	Kriva Palankë
Liria	f. Jabolchisht	Çashkë
Bllazhe Koneski	Veles	Veles

Shkollat prej fazës së dytë dhe fazës së tretë të projektit janë poashtu të përzgjedhur. Rezultatet mund t'i shikoni në faqen tonë të internetit.

U falënderojmë të gjitha shkollave që aplikuan për pjesëmarrje dhe shpresojmë se do të kemi bashkëpunim të suksesshëm me shkollat e përzgjedhura!

#### AKTIVITETE TË PLANIFIKUARA:

15 - 18 tetor

Punëtori për anëtarët e grupit punes për përshtatje të instrumenteve për vlerësim të dijës nga fusha e gjuhës (EGRA) në gjuhën maqedonase dhe shqipe

21 -25 tetor

Punëtori për anëtarët e grupit punes për përshtatje të instrumenteve për vlerësim të dijës nga fusha e matematikës (EGMA) në gjuhën maqedonase dhe shqipe

11 - 15 nëntor

Trajnim për vlerësuesit për EGRA dhe EGMA

10 shtator – 10 tetor, 2013

**E-lajme**